



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA DREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 05.02. 2026		
Njësi.org. Org. Jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016	101-000	7972126
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Kompania rajonale "Pastrimi"



Më datë: 02.02.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në mes:

Komunës së Podujevës më tej 'Komuna', me adresë në Rrugën "Nuhi Gashi" në Podujevë, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – z. Shpejtim Bulliqi

dhe

Kompanisë Rajonale për Mbeturina "Pastrimi" SH.A, më tej "Kompania" me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutiv, z. Petrit Reçica

Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Komunës së Podujevës dhe Kompanisë Rajonale "Pastrimi" SH.A, është ofrimi i ndihmës për participim në pagesën e 6 (gjashtë) punëtorëve fizik sezonal të Kompanisë për periudhën prej 12 muajve
2. (Prej muajit Shkurt 2026 deri në Shkurt 2027) për kryerjen e punëve në menaxhimin e mbeturinave, si në vijim:
 - 2.1. Largimin e deponive ilegale;
 - 2.2. Largimin e mbeturinave voluminoze;
 - 2.3. Pastrimin e sipërfaqeve publike;
 - 2.4. Punët tjera, varësisht nga nevoja në terren, për të ndihmuar Njësinë e Kompanisë në Podujevë në grumbullimin e mbeturinave.

Neni 2
Vlera e financimit

1. Vlera e përgjithshme për pagesën e punëtorëve sezonal, sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje është në shumë prej 36.000.00 €.
2. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Komuna e Podujevës do të participoj me mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €.
3. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, do të participoj me mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €
4. Paga mujore për 6 punëtorët sezonal sipas kësaj marrëveshje caktohet në shumë prej 500 € bruto në muaj për secilin punëtor për periudhën 12 mujore.

Neni 3
Obligimet e Komunës

1. Komuna e Podujevës obligohet që për pagesën e punëtorëve sezonal ,sipas kësaj marrëveshje të siguroj mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €.nga buxheti i Komunës.
2. Të caktoj një përfaqësues nga Komuna e Podujevës në cilësinë e mbikëqyrësit të realizimit të punëve në terren sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Komuna e Podujevës mjetet financiare në shumë prej 18.000.00 €, do t'i transferoj në llogarin bankare të Kompanis Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A me nr. 1700200100051292 në NLB.

Neni 4
Obligimet e Kompanisë

1. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A , obligimet që për pagesën e 6 punëtorëve fizik sezonal të siguroj mjete financiare në shumë prej 18.000.00 €.për ngritjen e kualitetit të grumbullimit të mbeturinave për interesin e përgjithshëm të qytetarëve.
2. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A – Njësia në Podujevë, në bashkëpunim me Komunën e Podujevës monitoron mbarëvajtjen e menaxhimit të mbeturinave dhe punëve tjera mjedisore në funksion të pastrimit të hapësirave publike në terren.
3. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' SH.A, duhet t'i dorëzoj raport me shkrim Komunës së Podujevës për realizimin e punëve në terren si dhe për shpenzimin e mjeteve të destinuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5
Zbatimi

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme dhe e vlefshme deri në përmbushjen e obligimeve nga të dyja palët.

Neni 6
Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet e krijuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të zgjidhen përmes bisedimeve midis palëve. Nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 7
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Bashkëpunimit është përpiluar në kopje identike dhe të mjaftueshme për secilen palë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

Nënshkruar më datë: 02.02.2026

KRM "Pastrimi" SH.A

Petrit Rexhe



Kryetari i Komunës

Shpejtim Bulliqi

